



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/ 150
Datë: 20.03.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023.
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Urbanizmit për vitin 2022.
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2023.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veçanta, për gjashtë mujorin e dytë për vitin 2022.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të luftës, për vitin 2022.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve, për ndërmarrjen publike "EKO-Regjioni" SH.A Prizren, njësia në Malishevë.
8. Shqyrtimi i kërkesave.
9. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 20.02.2023 dhe filloi në ora: 09:30. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Gentianë Hoti, Hamit Lima, Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, Kfori zvicëran, përfaqësuesi nga drejtoria e arsimit Sabit Berisha, përfaqësuesi nga drejtoria e shërbimeve publike Fadil Shala dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi gjashtë antarë, një anëtare mungon me leje dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. I kemi dy pika të rendit të ditës që propozoj që të futet në rend të ditës që është Plani i punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023 Kush është për që kjo pikë të futet në rend të ditës?

Me vota unanime, Plani i punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport futet në rend të ditës.

Pika tjetër që të futet në rend të ditës është: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për transportin publik urban. Kush është për?

Me vota unanime, dhe kjo pikë futet në rend të ditës.

Shkojmë në votim të rendit të ditës. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: shqyrtimim dhe miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kush është për?

Me vota unanim, miratohet procesverbali.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për transportin publik urban. Prezent është kryetari i Komisionit të kësaj Rregullore. Urdhëro, Fadil!

Fadil Shala: Përshëndetje për të gjithë!

Pas formimit të Komisionit ne si drejtori kemi filluar për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për transportin publik urban, i cili ka qenë në fuqi që nga 15 marsi 2010. Ky plotësim dhe ndryshim është kërkuar për të vetmen arsye se ka ndryshime të legjislacionit aktul që është për transportin publik, kryesisht për Ligjin për transportin rrugor, ka ndryshime të Udhëzimeve, Ligji për kundërvajtje. Ne kemi qenë të obliguar që këto ndryshime dhe plotësime t'i përfshijmë në Rregulloren e re. Kryesisht është rregulluar transporti i udhëtarëve që është me operatorët ekonomik që ne i njohim me autobus dhe transporti rrugor me autotaksi, dhe transporti i mallrave. Kjo Rregullore i përmban 63 nene.

Argjend Thaçi: Nga materiali shihet që është një Rregullore mjaft voluminoze dhe shpresojmë që është më e mira e mundshme. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Fadil, ne sot e murrum draftin e Rregullores, që do ishte mirë ta kemi së bashku me materialin. Në shikim të parë siç tha dhe kryesuesi është një Rregullore mjaft voluminoze, mirëpo për me i dhënë vrejjet dhe sugjerimet tona na duhet pak kohë.

Kjo Rregullore a i trajton të gjitha linjat urbane brenda komunës tonë, a përfshihen dhe autobusët që vinë psh nga Rahoveci. A e zbatojnë këtë Rregullore dhe këtë autobusë dhe pse s'janë të komunës tone?

Sa kompani dhe sa taksi operojnë në komunën tonë dhe ai nënshtrohen kësaj Rregullore?

Ky vendi i taksi te Sheshi i Dëshmorëve, ndoshta duhet me u rishqyrtu, sepse është një vend jo adekuat për ta.

Sa i përket biletave është një ngritje enorme e biletave dhe këtu e pash një nen që e rregullon qmimin për këto kompani, ndoshta do ishte mirë me ju përcaktu qmimin në bazë të kësaj Rregullore. Unë pak udhetoj me autobus dhe ajo çka kam vërejtuar që asnjëri nuk ka aparat për ark fiskale dhe në anën tjetër i kanë qmimen enorme. Prej Lladrovci deri në stacion të autobusëve janë diku 9 km dhe bileta është 80 cent udhtarët dhe ata nuk lëshojnë asnjë kupon fiskal,. Ndoshta do ishte mirë të parashihen në Rregullore këto dhe me i inspektu pastaj.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Fadil!

Fadil Shala: Ne kemi transportin e udhëtarëve urban dhe ndërurban dhe brenda komunave normalisht që bien dhe transportuesit që janë ndërurban, që janë kompetencë e Ministries.

Veton Zogaj: A paguajn këta transportues në stacionin e autobusëve ?

Fadil Shala: Normalisht që paguajnë, sepse ata hyjnë në stacion të autobusëve siç e ka Rregullorja mbi stacionin e autobusëve. Sa i përket arkave fiskale këtu është e cekur që duhet të bëhet pagesa dhe duhet dhënë bileta-ose kuponi fiskal dhe këtë qështje të zbatueshmërisë së saj duhet ta bëjë Inspektoriati.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

Si Rregullore është e përcaktuar mirë çdo gjë, mirëpo te mbikqyrja e kam një vërejtje sepse nuk po mbikqyren. Psh nxënësit e Qendrës së Kompetences zbresin në stacion dhe duhet të vinë në këmbë deri te shkolla. Duhet ta keni parasysh këtë dhe të bëni presion dhe ju si drejtori te kompanit që me pas të sigurar transportin deri te qendra e kompetencës.

Fadil Shala: Rregullorja e trajton këtë qështje, mirëpo kur të bëhet shpallja vazhdimi i vijave urbane aty shënohet stacioni i nisjes dhe i ndaljes.

Rukije Bytyqi: Dhe gjatë kohës së verës duhet t'i zbatojnë linjat që i kanë, sepse në momentin që nuk po ka nxënës nuk po i zbatojnë linjat që i kanë.

Fadil Shala: Kompetenca është e drejtorisë së inspektoriatit dhe ne kemi pasur grupe të caktuara të qytetarëve që kanë bërë ankesë për shkak të mos ardhjes së linjave të autobusit dhe ne i kemi shqyrtuar ato raste, mirëpo janë raste të rralla të ankesava.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Përshëndetje për të gjithë!

Unë po ndërlihem te stacionet e autobusëve, te vetëndaljet, a keni ndonjë nen që nëse nuk ju përmbahet këtyre pikav, me ja heq linjat. Ka shumë raste që në mes rrugës ndalen autobusët, kjo është e rrezikshme. Kjo Rregullore a i përcakton dhe qmimet e biletave, sepse nuk shkon bileta si prej Bellanicës me ardhje në Malishevë si prej Banje në Malishevë.

Këta autobusë që janë a janë të obliguar të shkojnë të gjithë në stacion të autobusave, sepse këtu afër komunës po bëhet një lloj tollovi ku gati 30 min po i presin udhëtarët.

Fadil Shala: Ne e kemi Rregulloren për tarifa dhe ngarkesa ku parashihet qmimi që duhet të paguhet për linjen që e ushtron. Kur bëhet shpallja apo vazhdimi i viave urbane ne i kërkojmë ta jep dhe ofertën e qmimit për transportin që e ushtron, pastaj formohet komision dhe i shqyrton të gjithë dokumentacionin dhe në vendim shënon që janë obligues të ju përmbahen stacioneve. Në kuadër të kësaj Rregullore dhe kur bëhet shpallja e vijave ne do kërkojm dokumente shtesë një vërtetim nga stacioni i autobusëve se sa ka qenë operues ata në stacion dhe neve na lehtson punën, sepse në të njëjtën kohë krijohen dhe të hyra për stacionin.

Hamit Lima: Kjo duhet të vlejë dhe për kompanit tjera psh për Mendin, Shehun dhe të tjerat kompani të cilat nuk hynë në stacion.

Fadil Shala: Ato i përcjell policia dhe inspektoriat në nivel qendror dhe unë sa jam në dijeni pothuajse të gjithë hynë në stacionin e autobusëve

Hamit Lima: Sa i përket qmimit janë disa punë që ne duhet t'i përcaktojmë psh qmimin e transportit të udhtarëve mund ta përcaktojmë ne.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Sadik!

Sadik Vrenezi: Qfarë masa keni marrur për kombibusat që operojnë ilegalisht?

Fadil Shala: Shqiptimin e masave e bënë Inspektoriat dhe nuk e di si ka shqiptu dhe sa ka shqiptu.

Argjend Thaçi: Kush është për që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023. Prezent e kemi përfaqësuesin e DKA-së Sabit Berisha. Urdhëro!

Sabit Berisha: Përshëndetje për të gjithë!

Ne si drejtori komunale e arsimit, pas përfundimit të vitit shkollor kemi marrur të gjitha masat dhe i kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat e nevojshme që i kemi pasur nga tereni. Me marrjen të të gjitha këtyre kërkesave, së pari ka qenë e nevojshme që të hapen disa konkurse për nevojat dhe kërkesat e mësimdhënësve. Përveq këtyre kërkesave ne kemi pajisur nxënësit dhe me libra për vitin shkollor. Kemi bërë furnizimin me lëndë djegëse dru dhe pelet, kemi bërë ndryshimin në disa shkolla nga furnizimi me dru në pelet.

Jemi fitues të çerdhes në Banjë që ka filluar dhe kemi bërë përgaditjet për finalizimin saj. Gjatë kësaj kohe kemi paraparë dhe hapjen e dy çerdheve, mirëpo për shkak të disa problemeve që kanë ndodhur gjatë procesit të pjesa e aneksit në komunën e Malishevës është bërë pak vonim, mirëpo dhe ato probleme janë sanuar dhe ne kemi hapur konkursin ku Ministria na ka lejuar 23 vende të reja si numër fizik për mësimdhënës në ato në Kijevë dhe Malishevë. Ne në konkurs kemi hapur 14 vende për arsye se kemi numër të madh fizik brenda institucionit parashkollor. Gjatë kësaj kohe kemi zhvilluar dhe një konkurs për drejtor të shkollave i cili i ka përfunduar të gjitha fazat, mirëpo në fazën e fundit ai konkurs është ndalë sepse një drejtor ka konkuruar në 5-6 shkolla dhe nuk ka qenë i mirfilltë.

Sukses ka qenë hapja e drejtimeve të reja siq është e mjeksisë dhe profilet e tjera teknologjike.

Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Ju përgëzoj për Raportin dhe janë përfshir të gjitha çka janë bërë. Desha të ndalem te disa pika sidomos te ngrohja nëpër shkolla të cilat kanë pasur probleme me nxemje. Dihet dhe shihet që është normalizu me ndërrimin e kalldajave që janë bërë nëpër shkolla dhe kalimi në pelet ka qenë shumë e nevojshme po flas për shkollën "Hamdi Berisha" ku kemi pasur telashe dhe tani nuk kemi pengesa.

Si mësimdhënëse më shqetëson suksesi i nxënësve dhe mungesat e tyre. Te klasat e 10,11,12 interesimi për mësim e ka një rënje dhe besoj që ka ardhur koha që në Gjimnaz e kemi bërë dhe si kërkesë që të kalojmë në sistemin kabintetik ku do të ishte digjitalizuar dhe shkolla dhe do ishte diçka e re për nxënësit dhe ishte kthyer ai interes i nxënësve për mësim.

Te mungesa e nxënësve këtë po shihet që ka mungesë shumë të madhe të nxënësve dhe vetë jam kujdesatare e një klase dhe raporti mësimdhënës prindër nuk është dhe aq i mirë, sepse i ke 20 nxënës dhe në mbledhjet që i mbajnë me prindër pjesmarrës janë vetëm 4 ose 5 prindër.

Është mirë që e kemi bërë ndalimin e shisha bareve dhe Inspektoriati i ka mbyllur dy kafiteri dhe është mirë me bërë inspektime të vazhdueshme. Unë kisha kërkuar që prindërit t'i vizitojnë sa më shumë fëmijët në shkollë dhe ta kemi një bashkëpunim. Ju kur ti mbani takimet me këshillat e prindërve kërkon vazhdimisht që ata të jenë të pranishëm nëpër shkolla dhe jo të vinë vetëm në javën e fundit të vitit. Arsyeja e braktisjes në shkolla, në shumicën e rasteve ne si kujdestar nuk e marrim informacionin të saktë se çka po ndodh me ata fëmijë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Sabit!

Sabit Berisha: Mos suksesi i nxënësve, mos interesimi i tyre nëpër shkolla na brengos të gjithëve. Ne jemi munduar që të bëjmë më të mirën gjithmonë, ju kemi ofruar tabela digjitale, mirëpo për me rrit interesin e tyre na duhet një bashkëpunim i të gjithëve

Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Mbledhjet me prindër mendoj që ta bëjmë pas orarit të punës, sepse shumica e prindërve janë në marrëdhënie të punës dhe ju si drejtori ta bëni si rregullt që mbledhjet me prindër të mbahen pas orarit të punës në ora 5-6 ose 7, sepse besoj që do të ketë efekt më të mirë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: A parasheh ndonjë rregullore se sa nxënës duhet t'i ketë një klasë, sepse unë e di një rast që një klas i ka 34 nxënës e tjetra klas 11 nxënës. Pse mos të ndahen këta nxënës dhe klasët të jenë të barabarta me numuër të nxënësve.

Sabit Berisha: Ministria e Arsimit duke e parë rënien e numrit të nxënësve numrin në paralele e sheh me 12 nxënës.

Hamit Lima: Psh klasa e parë psh janë 45 nxënës dhe të ndahen njëra klas 22 e tjetra 23.

Sabit Berisha: Ne kemi pasur probleme në vitin 2023, sepse pridëri dhe nxënësi kanë të drejtë me zgjedh mësuesen dhe kemi pasur problem te ndarja e nxënësve kur kanë filluar klasën e parë

Hamit Lima: Unë po flas për fshatin Banjë. Mirëpo nëse x personi nuk është mësues i mirë dhe çdo gjenerat që vjen nuk shkojnë te ai dhe ka rëmje, aty duhet të merren masa.

A keni marr masa për problemet që janë me banjo, sepse shumica nuk janë funksionale psh në shkollën "Ibrahim Mazreku".

Sabit Berisha: Koha e pandemies ka shkaktuar probleme të jashtëzakonshme dhe financiare. Drejtoria e arsimit për ti realizuar këto gjëra duhet të kemi buxhet. Një problem që e kemi nëpër shkolla është sepse nxënësit po hynë dhe po i thejnë gjërat dhe ne nuk mund të vendosim kamera në banjo, me drejtor kemi pasur bisedime dhe ato probleme duhet të paguhen nëse nuk gjinden fajtori duhe ta paguajnë të gjithë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: E shikova Raportin dhe më vjen mirë që drejtoria e arsimit e ka marrur seriozisht këtë mandat dhe e shohë një përmirsim të dukshëm te Raportet që i sjellë.

Te planifikimi buxheti i shpenzuar janë 50.000.00 euro subvencione, a nënkuptoon kjo rruga që paguhet për fëmijët që nuk i kanë kushtet dhe a janë dhe bursat këtu. Çka nënkupton 50.000.00 euro subvencione? Komuna e Malishevës e ka përbyllur rregullimin e hapsirave publike, Turjaka është e fundit që po e ndërton shkollën dhe po krijohen mundësi më të reja, ndërsa në fshatrat tjera ka hapsirë të mjaftushme, ka probleme sanitare dhe te rrjeti elektrik.

Kryetari Kastrati e ka pas si premtim dhe drejtoresha e ka përmend bashkëpunimin me QKMF-në dhe realizimin e vizitave sistematike nëpër shkolla. A janë duke u bërë këto vizita dhe në qfarë periudha bëhen?

Shqetësim është numri i madh i braktisjeve së nxënësve nëpër shkolla, nga klasa parë deri te e nënta janë 85 nxënës që e kanë braktisur shkollën, 47 janë meshkur dhe 38 janë femra. Në shkollën e mesme janë 129 nxënës që e kanë braktisur shkollën, 77 janë meshkuj dhe 51 femra, kjo është shqetësuesë sepse në anën tjetër kemi një staf të madh të mësimdhënësve.

Sa i përket konkursit për drejtor, mirë që është ndalu dhe desha ta di se a ka të drejtë ligjore me vazhdu me ushtrues detyre deri në një fazë tjetër.

Këto tre shkollat në Banjë ka filluar qerdhja që është investim nga Qeveria dhe këto dy shkollat që janë në fazën finale e di që niveli qëndror i ka ndarë do buxhet për shkollën në Dragobil dhe shkollën në Malishevë, unë dua ta di se kur pritet me u përfundu këto.

Sabit Berisha: Dhe për këto ne kemi bërë kërkesë në Ministri, nuk e di sa është mundësia me u përmbyll komplet projekti, por nu ka thënë që kanë me lëviz në këtë drejtim, dhe për x arsye është shtyrë vit mas viti. Këtë vit kemi paraparë dhe një qerdhe të re në fshatin Dragobil, në shkollën e vjetër , i kemi bërë paramasat dhe i kemi dërguar në Ministri të Arsimit dhe po presim aprovimin e tyre.

Veton, sa i përket atyre mjeteve ne dhe këtë vit kemi bërë transportin e nxënësve të lagjeve që janë larg shkollave, kemi ndarë bursa për student rreth 320 dhe nuk ka pasur diskriminim.

Te stafi kemi një staf kogja të madh dhe e falenderojm Ministrin me të cilën e kemi një bashkëpunim të mirë dhe kemi pasur klas që janë me 4-5 nxënës dhe kanë mundur me na kushtëzu me ba sistemimin prej shkollave në shkolla, ose me klas të kombinueme, mirëpo realish nuk jemi në atë fazë dhe nuk kemi pasur penges për me reduktu puntor të ri.

Sa i përket konkursit të drejtorëve kryetari e ka anulë shkaku se një person ka aplikuar ne 5-6 vende.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: A e trajton drejtoria e arsimit transportin e fëmijëve psh distancën me shkollë, apo duhet të bëjë kërkesë dikush tjetër për këtë transport dhe sa është distanca që duhet të jetë që të bëhet kërkesa.

Sabit Bersha: Distanca duhet të jetë më shumë se 3km, ndoshta ka ndonjë shkollë që përfshihet më pak se 3 km.

Hamit Lima: Kjo qerdhja në Banjë a është në mbikqyrje prej komunës apo Ministries?

Sabit Berisha: Ministria është përgjegjëse për qerdhen në Banjë.

Argjend Thaçi: Sabit, faleminderit për interpretimin e Raportit.

Kalojmë në pikën tjetër Shqyrtimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Urbanizmit për vitin 2022. Nuk kemi prezantuar asnjë përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit, mirëpo ne po e kalojmë për Kuvend pastaj e diskutojmë në kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi i Planit të punës së Zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2023. Përfaqësues nuk e kemi askënd.

Veton Zogaj: Unë menjëherë që kjo pikë duhet të shtyhet pasi këtu duhet të ishte prezent dikush që ti merr rekomandimet tona për këtë Plan.

Rukije Bytyqi: E dërgojmë në Kuvend pastaj aty bisedojmë për rekomandime.

Gentianë Hoti: Ne e dërgojmë në kuvend, me kërkesën që të jetë prezent përfaqësuesi.

Argjend Thaçi: Kush është për që të rekomandohet për kuvend Plani i punës së Zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2023?

Për: 4

Kundër: 2

Abstenim: 0

Me 4 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veçanta, për gjashtë mujorin e dytë për vitin 2022. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kryesues, këtë Raport nuk e rekomandoj për Kuvend, sepse u gjithë Komiteti është i përbërë nga njerëz të shëndetësisë dhe e binë një Raport me një faqe e gjysmë ky mund të jetë një hyrje e Raportit, por nuk mund të jetë Raport.

Argjend Thaçi: Të gjitha Komitetet janë formuar me vonesë.

Veton Zogaj: E kuptoj që janë formuar me vonesë, mirëpo i kanë mbajtur nga 6 mbledhje dhe kanë bërë vizita dhe Raporti ka një faqe e gjysmë dhe bëhet prej profesionistëve shëndetësor këtu e kam hallin. Unë mendoj ti kthehet mbrapsht dhe ti kërkohet që të shënohet Raporti siç shënohet dhe le ta sjellin. Unë nuk mund ta quaj Raport një faqe e gjysmë.

Argjend Thaçi: Ne mund ta qojmë për rekomandim për kuvend. Kush është për që të rekomandohet për Kuvend Raporti të punës së Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veçanta, për gjashtë mujorin e dytë për vitin 2022?

Për: 4

Kundër: 2

Abstenim :0

Me 4 vota për, dy kundër dhe asnjë abstenim, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të luftës, për vitin 2022. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: E kam lexuar Raportin dhe shihet që i kanë bërë disa aktivitete dhe i kanë bërë disa rekomandime që më kanë pelqy dhe e kanë bërë një kërkesë që të plotsohet Komiteti dhe me dy anëtarë. Rekomandim kanë: funksionalizimin sa më parë të objektit të organizatave të daluara nga lufta, mundësimi nga ana e qeveris komunale që të ketë një veturë zyrtare për shfrytëzim, kuvendi komunal të ndaj buxhet vjetor për mirëmbajtjen e varrezave, kuvendi të fus në kalendarin e qmimeve dhe masakrën e Llapqevës, rekomandim tjetër është që në emërtimet e rrugëve të ketë dhe emra të dëshmorëve të cilët deri më tani nuk figurojnë si emra në asnjërin prej rrugëve.

Argjend Thaçi :Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Unë i përgëzoj për angazhimin e këtij Komiteti. Sa i përket rekomandimeve unë pajtohem me to, përveq te pika 3mundësimi nga ana e qeverisë komunale që të jepet një veturë zyrtare. Ne sa herë po kemi seanca solemne, kur bëjmë homazhe ose kur i festojm këto festat që i kemi dhe qdoherë, komuna ju heq transportin qytetarëve dhe çdo herë është një autobus në dispozicion të qytetarëve dhe janë veturat zyrtare që ata mundën me i shfrytëz. Nuk e di sa është e arsyeshme që ata të kenë një veturë zyrtare, mirëpo nëse kanë mundësi me ja dhënë unë nuk jam kundër kësaj.

Argjend Thaçi: Kush është që kjo pikë të rekomandohet për kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër:Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve, për ndërmarrjen publike "EKO-Regjioni" SH.A Prizren, njësia në Malishevë Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ne si komunë, si komision e keni të drejtën me formu një bord ashtu siç është te stacioni i autobusëve.

Hamit Lima: Në kuadër të kësaj ish vetëm një përfaqësues jo vetëm për Malishevë por për Prizren dhe aty ish Muharremi. Mirëpo ne si fillim do të shkojmë te vizitë të kompania me i shiku përqindjet si i kanë sepse këta ishin si aksionarë me komunën dhe duhet të mendojmë se qka me ba.

Veton Zogaj: Në komunën tonë ka shumë deponi ilegale të mbeturinave dhe ndoshta është mirë që ju si komision me mujt me i ivedinentu ato dhe me i trajtu.

Hamit Lima: Ekoregjioni shkon e merr berllugi, ndërsa barin, hekrat, gjamat nuk i merr, nuk e di pse paguhet ai. Punëtorët e Ekoregjionit i marrin korpat e berllogit i mshon e then dhe nuk jep përgjegjësi askush. Ekoregjioni ka kërkuar rritje për 2 euro, rritjen po e kërkon mirëpo pse po e kërkon.

Veton Zogaj: Unë e kam bërë renovimin e banesës dhe të gjitha mbetjet i kam vendos posht dhe i kanë marrë dhe e paguj 4 euro e 50 cent.

Hamit Lima: Ne urgjentisht duhet të merremi me mbeturinat, sepse gjithka janë duke i gju. Duhet të jetë një rregull, një ligj dhe të ketë dënime të forta.

Veton Zogaj: A keni me zgjedh ju këtë drejtorin e kompanisë?

Hamit Lima: Më duket po.

Ka persona që nga pas lufta se ka paguar asnjëherë Ekoregjionin.

Argjend Thaçi: Kush është për që kjo pikë të rekomandohet për kuvend? Me vota unanime kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër:Plani I punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023.

Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Nëse ka ndonjë vendim të shkruar që drejtorin e ekonomis dhe financave që nuk i paguan realisht ne duhet ti shuajm këto komitete, sepse ne nuk mund të kërkojm plane e raporte. Në këtë mbledhje duhet te sqarohet dhe të definohet. Këto duhet të paguhet që mos ti mbesim askujt borgj.

Argjend Thaçi: Çdo vendim I Kuvendit do të paguhet.Kush është për që Plani I punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport të rekomandohet për kuvend.

Me vota unanime kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër shqyrtimi I kërkesave. Kërkesë nga Osman Krasniqi kërkoj nga Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër të del në teren që të na ndaj një sipërfaqe të mjaftueshme për odë të pritjes në lagjen Kapllanaj, andaj kërkojm nga ana juaj një ndërtim të tillë. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Për këtë qështje e kam pyetur dhe Drejtorin Bashkim dhe drejtorin nuk implikohet në këto. Këto objekte janë duke u ndërtuar jashtëligjshme.

Argjend Thaçi: Ne po ja rekomandojm Gjeodezisë dhe Urbanizmit. Kush është për që kjo kërkesë ti rekomandohet Gjeodezisë dhe Urbanizmit?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Drejtorin e Urbanizmit dhe Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastër.

Kërkesa nga Komiteti për familjet e Dëshmorëve kërkon që kërkesa e ardhur nga OVL-ja e UÇK-së, dega në Malishev,ë që përmes Komitetit të adresohet në KPF-ë për shqyrtim dhe miratim. OVL-ja e UÇK-së në Malishevë në kordinim me zyrën e kryetarit ti bëjnë të mundur zyrës së OVL-së në Malishevës të ketë në dispozicion një një makinë zyrtare të komunës së Malishevës që të jetë në shërbim të këtyre organizatave.

Veton Zogaj: Ne mundemi me pyet kryetarin në kuvend.

Argjend Thaçi: Unë kam folur për këtë qështje dhe me Drejtorin e Administratës. OVL-ja e UÇK-së e ka trajtimin e njejtë sikurse një drejtor që e bënë një kërkesë që e ka një vizitë zyrtare. Kush është për që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër?

Me vota unanime, kjo pikë shtyhet për mbledhjen tjetër.

Kërkesa tjetër është prapë nga Komiteti I Dëshmorëve që kërkohet që këti Komiteti t'i shtohen dy

anëtarë, një anëtarë nga OVL-ja e UÇK-së dhe një anëtarë nga zyra e kryesuesit. Dhe te kjo kërkesë unë mendoj që OVL-ja e UÇK-së është institucion në vete. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Herën e kaluar dhe OVL-ja e ka pasur përfaqësuesin e vetë në Komitet dhe kryetari e ka pasur përfaqësuesin e vetë. Kur janë ndarë qmimet për trimëri dhe heroizëm, janë marrur vendimet në Komitet.

Argjend Thaçi: Këto qmime po i ndan Komisioni që po formohet për 16 qeshorin që ka një përbërje prej 9 anëtarëve. Kush është për që kjo pikë të shtyhet për mbledhjet e radhës?

Për: 5

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 5 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim kjo pikë shtyhet.

Kërkesa tjetër është: Ajshe Krasniqi e cila kërkon nga KPF-ja ndihmë financiare pasi është e sëmurë me kancer.

Gentianë Hoti: Kryesues te këto kërkesat pa dyshim që të gjitha kanë nevojë, mirëpo duhet ta dimë që ato kërkesa që i kemi ndihmuar në Kuvend, a ju kanë dalur mjetet.

Argjend Thaçi: Po ju kanë dalur mjetet. Kush është që kërkesa e Ajshe Krasniqit të rekomandohet për Kuvend?

Me vota uananime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është Edonjeta Krasniqi kërkon ndihmë financiar për vajzën e saj e cila është e sëmur nga sëmundja e zembrës. Kush është që kjo kërkesë të dërgohet për Kuvend?

Me vota uannime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është Fidaie Krasniqi e cila kërkon ndihmë financiare për shkak të kushteve të rënda ekonomike dhe para pak ditësh kam pasur një operacion, të bashkangjitur keni të gjitha raportet dhe është në karroc.

Veton Zogaj: Kemi shumë persona që janë në karroc dhe mund të na vërshojnë kërkesat.

Gentianë Hoti: Të ja ndajmë një shumë prej 300E.

Argjend Thaçi: Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 350E.

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 350E.

Kërkesë tjetër është nga Selajdin Sopaj kërkon ndihmë financiare për sëmundjet, të gjitha shpenzimet e kancerit deri tash I kam mbuluar vetë, mirëpo meqenëse sëmundja ka filluar prapë duhet prapë trajtim dhe nuk kemi mundësi financiare. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 500E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është Erdi Bytyqi i cili është i sëmur me kronik bajamet të cilat ja dëmtonin dëgjimin, prandaj mjekët na udhëzuan të bëjmë një operacion për heqjen e bajameve. Kush është që Erdi Bytyqit

t'i ndajm 400E.

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 400E.

Kërkesa tjetër është Agron Morina, i cili gjatë aksidentit ka humbur dorën dhe për mjekim shpenzimet po janë të pa përballueshme dhe kërkojë ndihmë financiare.

Gentianë Hoti: A mundemi dhe kësaj kërkesë dy herë të ja ndajmë nga 500E.

Rukije Bytyqi: Ky e ka humbur krahun dhe tani vetëm ka me shëru dhe të ja ndajmë 500E.

Veton Zogaj: Të vendosim një standart që rastet me kancer ti dërgojm në kuvend. Nëse e dërgojmë në Kuvend këtë kërkesë unë jam me dallu me këto rastet me kancer.

Argjend Thaçi: Kush është që kërkesa nga Agron Morina të rekomandohet për kuvend?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është Egzona Kryeziu, këtë kërkesë e kemi pasur dhe në mbledhjet tjera dhe kësaj po ja ndajmë 500E. Kush është për që kësaj kërkesë t'i ndahen 500E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është nga Rifat Zulfaj nga fshati Senik, jam rast social dhe gjatë punës kam prerë dorën dhe nuk po jam në gjendje të punojë dhe kërkoj ndihmë financiarisht. Kush është që kësaj kërkesë t'i ndahen 300E.

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 300 E.

Kërkesa tjetër është nga Liman Toplana, i cili kërkon ndihmë financiare pasi bashkshortja është disgnostifikuar me kancer të gjirit.

Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Nëse nuk keni diqka për të shtuar te pika të ndryshme , këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Faleminderit për prezencën!

Mbledhja përfundoi në ora: 11:00.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

